



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 25/1 Prot.

Tiranë, më 25/1 /2011

Lënda: Rekomandim për “**Instituti i dobësimit Orchid**” Tiranë.

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, “**Instituti i dobësimit Orchid**” Tiranë,

KONSTATOVA

Më datë 16/05/2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, “**Instituti i dobësimit Orchid**” Tiranë, me objekt:

- Verifikimi i ankesës së shtetasit me inicialet A.B, lidhur me mesazhet promociionale të dërguara nga “**Instituti i Dobësimit Orchid**”.

Komisioneri “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolluesi “**Instituti i Dobësimit Orchid**” ka dërguar komunikime tregtare me karakter reklame përmes mesazheve të tipit sms-të shkruara, drejt numrave të ndryshëm përdoruesish të telefonisë celulare (AMC, Vodafon, Eagle), pa marrë pëlqimin paraprak nga subjektet e të dhënave personale, (mbajtës dhe përdorues të numrave të telefonave celularë) për ofrimin e këtij shërbimi.

Nga inspektimi administrativ i kryer rezultoi se, dërgimi i sms-ve promociionale është bërë nga vetë administratorja e këtij kontrolluesi. Mesazhet promociionale janë realizuar nëpërmjet blerjes së një shërbimi për dërgim mesazhesh në internet, ofruar nga kontrolluesi “Eder Studio”.

Dërgimi i komunikimeve tregtare me karakter reklame përmes mesazheve të tipit sms të shkruar, drejt numrave të ndryshëm të përdoruesve të telefonisë celulare (AMC, Vodafon, Eagle), në vështrim të nenit 3 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, konsiderohet mbledhje dhe përpunim i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave (përdorues të numrave të telefonit), pasi numri i telefonit celular është një e dhënë personale ngushtësisht private i cili të çon në identifikimin e individit.

Dërgimi i komunikimeve tregtare me karakter reklame (ose promocion) përmes mesazheve të tipit sms, drejt numrave të ndryshëm të telefonisë celulare të subjekteve të të dhënave personale (mbajtës dhe përdorues të këtyre numrave celularë), duhet të bëhet duke respektuar kushtet dhe kriteret që parashikon ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, veçanërisht nenin 6 të tij i cili specifikon se:...” *Të dhënat personale përpunohen vetëm nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin*”

Kontrolluesi “**Instituti i Dobësimi Orchid**” në rastin e dërgimit të këtyre mesazheve nuk ka zbatuar nenin 6 pika 1/a i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” “... *Të dhënat personale përpunohen vetëm nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin*”

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

REKOMANDOJ

Në zbatim të nenit 6 pika 1/a të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi “**Instituti i Dobësimi Orchid**” të mos kryejë dërgimin e mesazheve të tipit SMS të shkruara, drejt subjekteve të të dhënave personale (përdorues të numrave të telefonit), pa marrë pëlqimin paraprak të shprehur të këtyre subjekteve për ofrimin e një shërbimi të tillë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI
FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

